

Nr. 31 / Prot.



Prot 11026/19
Dt. 12.05.2015
ANEKSI D

Ndryshimi i Kontratës së Koncesionit

të formës "BOT" (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit

Në zbatim të Kontratës Koncesionare me nr. Prot. 11026/7, datë 16.012.2014 "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan", e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k., mbi bazë të kërkesës të subjektit "Albtek Energy" sh.p.k., referuar pikës 29 "Ndryshime" dhe mbi bazë të ligjit. Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013, e cila është miratuar me VKM Nr. 97, date 17.12.2014 "Për dhenien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë", si dhe:

- A. referuar nenit 13 të Kontratës ku përcaktohet se vlera e investimeve është 21 600 000 Euro dhe pagesa e mbeshtetjes financiare do të kryhet nga Buxheti i Shtetit, duke filluar nga muaji i shtate nga data e fillimit të punimeve
- B. Panvaresisht sa paraqitet ne paragrafin A me sipër, Koncesionari ka detyrimin që të sigurojë vlerën e investimeve përmes financimit të Paleve të treta Financuese, për të mos u vendosur në pozitën e palës që ndodhet në mospermbushjen e këtij angazhimi, i cili është shkak për zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit, sipas nenit 17.12. të kontratës.



C. Meqenese gjate negocimit per financimin e vleres se investimit, ka rezultuar si nevojë, per shkak te legjislacionit ne fuqi, qe Autoriteti Kontraktor te shprehe me qarte angazhimin dhe pergjegjesite e tij per realizimin me sukses te ketij Koncesioni, palet e ketij Amendimi vleresojne te amendojne Kontraten e Koncesionit.

D. Në bazë të nenit 29.1 te Kontratës së Koncesionit sipas të cilit kjo Kontratë mund të pësojë ndryshime , shtesa dhe /ose zevendesime per pjeset e negociueshme te procedues referuar legjislacionit ne fuqi, vetem me marreveshje te paleve, palët:

Ministria e Mjedisit e Republikës së Shqipërisë, në vazhdim referuar si **“Autoriteti”** e përfaqësuar nga Z.Lefter Koka, Ministër , Titullari I Autoritetit.

DHE

Shoqërisë ‘Albtek Energy’ sh.p.k, në vazhdim referuar si **‘Koncesionari’**, e rregjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, me seli në Rrugën “Ibrahim Rrugova”, Sky Toëer, Zyra 13/2, Tiranë, me numër unik identifikimi (NUIS): L 41914013 H, me përfaqësuese ligjore Znj. _____, shtetase shqipëtare, në cilësinë e Administratorit.

Vendosën dhe ranë dakort me ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në paragrafin 5.2.2 të Kontratës, në fjalinë e dytë pas togfjalëshit *“pasuritë e paluajtshme”* shtohet togfjalëshi *“si dhe te drejtat të tjera të Konçesionarit nga kjo Kontratë”*

Neni 2

Në paragrafin 17 të kontratës bëhen këto ndryshime:

- 17.1, pika (iii) ndryshohet me këtë përmbajtje: *“Për shkelje serioze të kushteve të kontratës nga ana e Konçesionarit, parashikuar nga paragrafi 17.12.1, gërmat (a), (b) dhe*



(c), në rastet kur shkelja ka vazhduar për më shumë se 180 ditë pas njoftimit nga Autoriteti Kontraktues për një shkelje të tillë.”

- Në paragrafin 17.12.1 shtohet gërma (e) me këtë përmbajtje:” (e) Koncesionari, në rastet e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit, sipas këtij neni dhe nenit 17.1 , gërmat (i), (ii), dhe (iii), ka të drejtë të përfitojë vlerën e investimit të kryer.”

- Pas paragrafit 17.17.1 shtohet paragrafi 17.17.1 me këtë përmbajtje:”17.17.2. Në rastet kur Autoriteti Kontraktues i lind detyrimi, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate, për kthimin apo kompesimin e vlerës së investimit përkundrejt Koncesionarit, është i detyruar, që përpara se të përmbushë këtë detyrim të njoftojë Palën Financuese. Në këto raste Autoriteti Kontraktues nuk do të kryejë pagesën në favor të Koncesionarit pa kaluar afati prej 30 ditësh pas njoftimit të Palës Financuese.”

Neni 3

Në paragrafin 30.6 të Kontratës, pas fjalës “bashkëlidhur” shtohet togfjalëshi “si dhe amendamentet që mund të pësojë rast pas rasti”

Neni 4


Kopjet e hartuara

Ky Aneks kontrate hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje të cilat kanë të njëjtën vlerë ndërmjet tyre.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ndryshimi i Kontratës së koncesionit (Aneksi D) do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të palëve në përputhje me paragrafin 30.8 të Kontratës së Koncesionit dhe bëhet pjesë përbërëse dhe e pandarë e Kontratës së Koncesionit, në përputhje me paragrafin 29.2 të



Kësat Kontrate. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet nenshkrimi si datë e hyrjes në fuqi.

Për: **MINISTRINË E MJEDISIT**

Për: **"ALBTEK-ENERGY" Sh.p.k**

Z. Lefter KOKA

Znj. Stela GUGALLI

MINISTËR

ADMINISTRATOR

